



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 22 Janar 2021

Nr: 04

VENDIM

PËR KËRKESAT ANKIMORE NR. 1 TË Z. ARBEN QALLIU DHE NR. 2 TË PARTISË  
LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NDAJ VENDIMIT TË KOMISIONERIT  
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NR.7, DATË 14.01.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.01.2021, me pjesëmarrjen e:

Illirjan RUSMALI - Kryesues  
Elvin LAKO - Anëtar  
Elvis ÇEFA - Anëtar  
Koli BELE - Anëtar  
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

**Ankues 1:** Z. Arben Qalliu, përfaqësuar nga av. Z. Ervin Zoto;

**Ankues 2:** Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj;

**OBJEKTI:** Shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 1 të z. Arben Qalliu dhe nr. 2 të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim me objekt të përbashkët “Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.7, datë 14.01.2021 Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionerit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z, Arben Qalliu”, të paraqitura në KQZ në datën 18.01.2021.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 91, 92, 124, 126, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimin nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, nenet 19, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,



Data: 22 Janar 2021  
Nr. 4, ora 10:30

Për kërkesat ankimore nr. 1 të z. Arben Qalliu dhe nr. 2 të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.7, datë 14.01.2021

## Rrethanat e çështjes:

1. Në datat 28.12.2020 dhe 30.12.2020, subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) ka raportuar në ndërfaqen e KQZ-së për aktivitetet e ndaluara dy denoncime kundrejt z. Bujar Çela, deputet i Partisë Socialiste, mbështetur në publikimin në llogarinë personale të deputetit në Facebook të disa fotografive me banorë të njësisë administrative Hysgjokaj, në të cilat deputeti ka dalë duke pozuar bashkë me ta me certifikatat e lejeve të legalizimeve në duar. Fotografitë janë shoqëruar me postimin: “Këto ditë të fundvitit po i shfrytëzojmë në maksimum për të sjellë sado pak gëzim në këto familje punëtore, që një pjesë të konsiderueshme të kursimeve të tyre i kanë hedhur në këto banesa. Sot isha në Njësinë Administrative Hysgjokaj, ku preka nga afër punën e tyre të materializuar në kapital. PUNA VAZHDON. Punë-Vizion-Durim” dhe me postimin tjetër “Bashkë me urimin Gëzuar Vitin e Ri 2021!”.
2. Nisur nga ky raportim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nisur procedurën administrative kryesisht kundrejt z. Arben Qalliu, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Lushnje, ka zhvilluar më datë 11.01.2021 seancë dëgjimore me drejtorin e drejtorisë vendore dhe, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin provues të depozituar nga raportuesi LSI dhe nga z. Arben Qalliu, më datë 14.01.2021 ka marrë vendimin nr.7, me të cilin ka vendosur të dënojë me gjobë z. Arben Qalliu në shumën 1,500 (njëmijë e pesëqind) lekë “për shkelje të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
3. Komisioneri ka konstatuar se deputeti “nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 3 të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator” dhe ka vendosur mosfillimin e procedurës administrative kundrejt deputetit z. Bujar Çela, por ka “vlerësuar se veprimtaria e zhvilluar nga deputeti z. Bujar Çela, shpërndarja e lejeve të legalizimit, në veprimtari publike përbën shkelje të parashikimeve të nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, germa “a” të vendimit të Komisionit Rregullator nr.9/2020”.
4. Komisioneri ka vlerësuar se, për shkak se lëshimi i akteve kadastrale është përgjegjësi e drejtorit të drejtorisë vendore të ASHK-së (paragrafi 5 i nenit 10 të ligjit nr.11/2018 “Për kadastrën”), atëherë “përgjegjësia për shpërndarjen e këtij dokumentacioni në veprimtari publike në Njësinë Administrative Hysgjokaj, pjesë përbërëse e Bashkisë Lushnje, i ngarkohet Drejtorit të Drejtorisë Vendore ASHK Lushnje, z. Arben Qalliu, i cili me veprime apo mosveprime ka kontribuar në zhvillimin e këtij aktiviteti”. Komisioneri ka vlerësuar se dorëzimi fizik i certifikatave të legalizimit në vendbanimin e përfituesve dhe jo në sportelet e institucionit apo në postë formon tejkalim të autoritetit të tij diskrecial. Sipas Komisionerit, kjo shkelje ka lehtësuar aksesin dhe disponimin e dokumenteve shtetërore nga subjektet politike dhe ka bërë të mundur përdorimin nga ana e tyre në kundërshtim me përcaktimet e nenit 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
5. Komisioneri nuk e ka gjetur përgjegjës drejtorin e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Lushnje, për shkelje të nenit 10 të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, për mosraportim të veprimtarisë publike apo për zhvillimin e një veprimtarie publike që është ndaluar nga KQZ-ja. “Me veprime të drejtpërdrejta z. Qalliu ka kontribuar indirekt që stafi në varësi të tij dhe dokumentet zyrtare të lëshuara për qytetarët, të vihen në dispozicion të subjekteve politike për

të ushtruar aktivitete të ndaluara në kuptim të nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe pikës 1.3, germa ”a” dhe “b” të Vendimit nr.9, datë 24.12.2020”, të Komisionit Rregullator. Ky fakt, sipas Komisionerit hyn në kategorinë “shkelje të tjera të dispozitave të Kodit Zgjedhor”, të cilat dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë.

6. Kundër vendimit të Komisionerit nr.7, datë 14.01.2021 ka bërë ankim z. Arben Qalliu, i cili ka parashtruar se veprimtaria e tij drejtuese dhe aktet e nxjerra në ushtrim të detyrës kanë qenë konform legjislacionit të fushës dhe nevojave institucionale. Z. Arben Qalliu nuk ka kryer asnjë veprimtari me karakter publik, nuk është pjesë e fotove të postuara dhe nuk ka qenë prezent në asnjërën prej vendngjarjeve, ndërkohë që vetë fotot tregojnë se veprimtaria e deputete nuk ka qenë publike. Lejet janë shpërndarë nga specialistët e drejtorisë vendore në terren dhe jo nga persona të tretë dhe dokumentacioni i servitur prej tij e vërteton këtë fakt. Dorëzimi është kryer më datë 9 dhjetor, përpara afatit katër mujor që kërkon ligji. Për pasojë, thekson ai, vendimi është i pabazuar dhe duhet të shfuqizohet.
7. Kundër vendimit të Komisionerit nr.7, datë 14.01.2021 ka bërë ankim LSI, duke parashtruar se veprimtaria e denoncuar prej saj formon veprimtari të ndaluar në kuptim të pikës 1.3 të nenit 3 të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, se mjafton të konstatohet dhe provohet se është kryer në periudhën 4 muaj e deri në datën e zgjedhjeve dhe personat që i kanë kryer këto veprimtari automatikisht janë subjekt i sanksioneve administrative të parashikuara në nenin 10 të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, se përgjegjësia në këto raste nuk i takon vetëm zyrtarëve të përcaktuar në pikën 2 të nenit 3 të vendimit të sipërcituar por çdo personi që kërkon të përfitojë avantazhe të padrejta elektorale nga kryerja e veprimtarive të ndaluara. Sanksioni administrativ i rastit nuk mund të jetë ai i përcaktuar nga Komisioneri, por ai që përcaktohet nga pika 1 ose 2 e nenit 10 të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator.
8. Ankimet iu paraqitën KAS-it, i cili caktoi nga një relator për secilin prej tyre, z. Ilirjan Rusmali për kërkesën ankimore nr.1 dhe z. Elvis Çefa për kërkesën ankimore nr.2. Në seancën përgatitore të datës 20.01.2021 KAS-i vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesave ankimore dhe bashkimin e tyre në një çështje të vetme me relator z. Ilirjan Rusmali. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 22.01.2021, ora 10:30 dhe vendosi thirrjen në seancë të ankuesit z. Arben Qalliu, të ankuesit LSI dhe të përfaqësuesve nga administrata e KQZ-së.
9. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.7, datë 14.01.2021;
  - pamjet fotografike të faqes personale të Facebook-ut të deputetit Bujar Çela;
  - ekstraktin e ndërfaqes se KQZ-së të raportimeve për veprimtaritë e ndaluara, për raportimin e LSI-së të datës 28.12.2020 dhe të datës 30.12.2020;
  - relacionin për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Arben Qalliu, përgatitur nga drejtoria juridike e KQZ-së;
  - procesverbalin e seancës dëgjimore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me z. Arben Qalliu, datë 11.01.2021;
  - procesverbalin e mbledhjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për marrjen e vendimit nr.7, datë 14.01.2021;

- urdhërin e brendshëm nr. 3066, datë 09.12.2020 të drejtorit të Drejtorisë Vendore Lushnje të ASHK-së;
- procesverbalin nr.13688/1 Prot., datë 09.12.2020 të specialistit Orsel Sulovari, Drejtoria Vendore Lushnje e ASHK-së;
- procesverbalin nr.13688/2 Prot., datë 09.12.2020 të specialistit Olgert Leka, Drejtoria Vendore Lushnje e ASHK-së;
- procesverbalin nr.13688/3 Prot., datë 09.12.2020 të specialistit Ndriçim Çepa, Drejtoria Vendore Lushnje e ASHK-së;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

### **KAS-i konstatoi:**

1. Vendimi nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator disiplinon veprimtarinë e ekzekutivit dhe të administratës publike në varësi të tij. Veprimi i tij është i kufizuar në kohë dhe përfshin kryesisht periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve. Vendimi përcakton detyrimin për transparencë, vetëpërmbytje dhe kufizim për ekzekutivin dhe administratën publike, me qëllim që ata t'i ushtrojnë funksionet e veta publike me neutralitet ndaj garës zgjedhore. “Gara zgjedhore duhet të zhvillohet në kushte të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe fondet dhe burimet publike të mos përdoren për qëllime partiake” (pika 1 e nenit 1 të vendimit).
2. Vendimi nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator përcakton një listë me veprimtari të ndaluara për t’u promovuar dhe me veprimtari të ndaluara për t’u zhvilluar. Në rrethin e veprimtarive të ndaluara për t’u zhvilluar bën pjesë “shpërndarja në veprimtari publike e lejeve të legalizimeve, në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve (germa “a” e pikës 1.3 të nenit 3)”. Shpërndarja e lejeve të legalizimit është veprimtari rutinë e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, e cila nuk ndërpritet për shkak të periudhës zgjedhore. Ajo që vendimi ndalon është kryerja e saj përgjatë veprimtarive publike. Veprimtari publike, në kuptimin e pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe të germës “b” të nenit 2 të Vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator është vetëm veprimtaria që është e hapur për pjesëmarrjen e publikut dhe të medias, si dhe ajo që ka në agjendë informimin e publikut rreth saj. Kjo dispozitë e ligjit synimin konkret e ka pasur të frenojë praktikën e mëparshme të institucioneve që shpërndanin në kohë fushate certifikata legalizimi në tubime me karakter elektoral dhe që ndërmerrnin fushata publicitare arritjesh dhe suksesesh nën petkun e veprimtarisë informuese institucionale.
3. Lejet e legalizimit janë dokumente zyrtare të shtetit, por ato nuk bëjnë pjesë në kategorinë ligjore të “burimeve publike”. Dokumenti zyrtar nuk është burim, sepse nuk është aset. Burimet publike, sipas Kodit zgjedhor janë asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore (pika 2 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor). Përfshirja e specialistëve të drejtorisë vendore

të ASHK-së, Lushnje në veprimtari elektorale të deputetit z. Bujar Çela, qoftë edhe në numër minimal do formonte shkelje sipas Kodit Zgjedhor, për keqpërdorim të burimeve njerëzore. Por kjo linjë nuk mund të ndiqet nga KAS-i, sepse veprimtaria e deputetit, deri në këtë moment është politike dhe jo elektorale. Në kontaktin e tij me elektoratin, deputeti është në ushtrim të funksioneve të veta përfaqësuese dhe jo në fushatë. Regjistrimi i kandidatëve dhe fushata nuk kanë filluar ende.

4. Nga shqyrtimi i provave në dosje nuk rezulton e provuar se deputeti Bujar Çela të ketë ushtruar funksione që i përkasin Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Lushnje, as që të ketë dubluar punonjësit e saj gjatë ushtrimit të detyrës. Në rastin në shqyrtim, rezulton e provuar se deputeti Bujar Çela ka pozuar me banorë të pidentifikuar të Njësisë Administrative Hysgjokaj (sipas deklarimeve të veta dhe të denoncuesit), me certifikatat e lejeve të legalizimeve në duar, në mjediset e brendshme të banesave, në oborret ose në hyrjet e tyre. Rrethanat e rastit nuk provojnë shpërndarjen e certifikatave nga deputeti, por krijojnë bindjen, se ai ka marrë pjesë në proces. Nga ana tjetër, nuk rezulton e provuar që kryerja e veprimtarisë të jetë bërë në vende të hapura për publikun, në sheshe ose në njësitë e shërbimeve komunitare të zonës, apo që publiku të jetë ftuar në çfarëdo lloj forme për të marrë pjesë në veprimtari, apo media të ketë shoqëruar deputetin apo të ketë raportuar për ndonjërin nga këto veprimtari. Këto dilema kanë lidhje të drejtpërdrejtë me kualifikimin ligjor të shkeljes. Barra për kualifikimin e shkeljes, në rastin konkret për karakterin publik të veprimtarisë, i ka takuar ankuesit LSI që në momentin e depozitimit të raportimit. P.sh. ankuesi duhet të ndante paraprakisht nëse jemi përpara kryerjes së një vepre penale, apo përpara një shkelje administrative, përpara se të zgjidhte rrugën ligjore të reagimit.
5. Postimi në llogarinë e deputetit në Facebook nuk e bën veprimtarinë publike. Postimi dhe veprimtaria janë dy ngjarje të dallueshme qartë nga njëra tjetra dhe të zhvendosura në kohë. Nga ana tjetër, Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon pika 1 e nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias, që t’u konsiderojë veprimtarinë publike. Facebook-u nuk ka marrë pjesë në veprimtarinë e deputetit Çela, sepse Facebook-u nuk është media që “merr pjesë”. Sikurse pranohet nga vetë denoncuesi, qëllimi i veprimtarisë ka qenë shpërndarja e certifikatave, jo informimi i publikut rreth tyre. Postimi në Facebook nga ana e deputetit i përket një kohe të mëvonshme (në këtë kuptim formon veprimtari tjetër, të ndryshme nga e para) dhe është bërë për qëllime promovimi. Postimi nuk mund të trajtohet si informim.
6. Faktet e mësipërme provojnë se veprimtarisë së denoncuar i ka munguar karakteri publik që kërkon germa “a” e pikës 1.3 të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Karakteri publik është kushti që ndan lejimin nga ndalimi i veprimtarisë. Për këtë arsye, çdo referencë tek germa “a” e pikës 1.3 të nenit 3 të vendimit nr.9, datë 24.12.2020 është e pavend dhe nuk ndihmon gjykimin e çështjes. Për më tepër, pretendimi i ankuesit LSI, se KQZ-ja duhet të dënojë shkelësit në bazë të pikës 1 ose pikës 2 të nenit 10 të vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, gjithashtu nuk ka lidhje me rastin në fjalë. Sanksionet e referuara nga ankuesi LSI i takojnë rastit kur ka pasur veprimtari publike të raportuara dhe KQZ-ja ka ndërhyrë për ndalimin e tyre, nëpërmjet vendosjes së shënimit në ndërfaqen e veprimtarive “Ndaluar nga KQZ-ja”.

7. Z. Arben Qalliu, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Lushnje bart detyrimin për raportim për veprimtaritë publike që zhvillon, drejtpërdrejt ose nëpërmjet instancave eprore. Por shpërndarja e certifikatave të legalizimeve, për mënyrën se si është urdhëruar dhe zbatuar prej tij nuk formon veprimtari publike. Për këtë arsye ai nuk mund të vishet me përgjegjësi për mosraportim. Komisioneri ka analizuar përgjegjësitë e drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Lushnje dhe ka vënë re paligjshmëri në ushtrimin e detyrës në këndvështrimin e ligjit të fushës. KAS-i vlerëson se kompetenca e KQZ-së është të konstatojë dhe ndëshkojë paligjshmëri dhe shkelje nga këndvështrimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor, jo të legjislacionit të fushës, sepse përndryshe futet në kompetenca të organeve eprore të sistemit të ASHK-së, ose të organeve që kontrollojnë veprimtarinë e tyre.
8. Subjektet që i nënshtrohen veprimit të Kodit Zgjedhor mund të bëhen përgjegjës vetëm për shkelje të dispozitave të tij. Që ata të dënohen sipas këtij Kodi duhet që veprimet apo mosveprimet e tyre të bien ndesh me urdhërime apo ndalime të shprehura të Kodit. Përndryshe, pushteti diskrecial i organeve drejtuese të KQZ-së mund të tejkalonte kufijtë e ligjshmërisë. Lista e veprimtarive të ndaluara që ka përpunuar vendimi nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator nuk lejon ndërhyrjen me interpretime zgjeruese as nga Komisioneri, as nga KAS-i.
9. Kodi Zgjedhor, me pikën 1 të nenit 12 të tij e ka bërë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “institucionin përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor. Ky funksion i jep të drejtën KQZ-së të vendosë rregulla dhe standarde, apo të instalojë praktika uniforme, përtej mekanizimit të penaliteteve.
10. Është gjykim standardi gjykimi që e konsideron praninë apo aktivizimin e deputetit në veprimtarinë e administratës publike si veprim që i jep me ose pa dashje ngarkesë politike punës rutinë të administratës. Në veprimtari të tilla si shpërndarja e lejeve të legalizimit, administrata është brenda rrethit të detyrave të veta të ligjshme. Zbatimi i detyrës nuk është meritë, është korrektesë ligjore. Prania e deputetit e bën atë të perceptohet vetiu si meritë, si avantazh, si aftësi e posaçme, e cila ka lidhje vetëm me përkatësinë politike. Një përpjekje për të transformuar perceptimin e njerëzve në formën e pranisë, pjesëmarrjes apo angazhimit bashkë me administratën publike në kontaktin e saj me njerëzit, katër muaj para zgjedhjeve, edhe pse nuk ndalohet shprehimisht nga Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr.9, datë 20.12.2020 i Komisionit Rregullator, bie ndesh me standardin e zgjedhjeve që kërkon ky Kod dhe me parimin e neutralitetit të shtjelluar në pikën 1 të konstatimeve më sipër. I takon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe grupeve parlamentare që të kujdesen, me qëllim që deputetët të respektojnë këtë standard dhe neutralitetin e administratës publike, deri në datën e zgjedhjeve, duke ushtruar vetkufizim ndaj veprimtarisë rutinë të administratës publike, kur ajo zhvillohet nëpërmjet kontaktit, komunikimit dhe bashkëpunimit me zgjedhësit;
11. Standardi i zgjedhjeve e kërkon që përdorimi i burimeve publike dhe zbatimi i detyrave nga administrata publike të trajtohen si të mira publike që i përkasin shoqërisë dhe që nuk bartin as përcjellin ngarkesa politike. Ky standard i kërkon Drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Lushnje, që të mos lejojë në asnjë rrethanë përdorimin politik të detyrës dhe të stafit të tij.

I njëjti standard kërkon që organi i tij epror të marrë masa që resurset dhe procedurat e veta administrative të mos shfrytëzohen për përfitime të padrejta politike.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shumicë votash, KAS-i,

### **V E N D O S I:**

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.7, datë 14.01.2021;
2. Pranimin e ankimit të z. Arben Qalliu lidhur me gjobën;
3. Rrëzimin e ankimit të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim për dënimin administrativ të deputetit Bujar Çela;
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të informojë Agjensinë Shtetërore të Kadastrës dhe t'i kërkojë që, në respektim të standardit të zgjedhjeve dhe neutralitetit të administratës publike, deputetët, deri në datën e zgjedhjeve të mos ftohen në veprimtaritë rutinë të administratës qendrore dhe vendore të tij, të cilat zhvillohen nëpërmjet kontaktit, komunikimit dhe bashkëpunimit me zgjedhësit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;  
Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 (ditëve), nga shpallja e tij.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Kryesues</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar (Kundër)</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar (Kundër)</b>

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 1 të z. Arben Qalliu dhe nr. 2 të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim me objekt të përbashkët “Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 14.01.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Arben Qalliu”, të paraqitura në KQZ në datën 18.01.2021, jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e ankimit të z. Arben Qalliu dhe rrëzimin e ankimit të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) duhet të refuzonte ankimin e z. Arben Qalliu dhe të pranonte pjesërisht ankimin e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për rikualifikimin e kundërvajtjes administrative të kryer nga z. Arben Qalliu, ndaj ju paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.
2. Si fillim sqarojmë se pjesë e këtij shqyrtimi administrativ kanë qenë dy ankime, një i depozituar nga z. Arben Qalliu, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Vendore Lushnjë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe tjetri i depozituar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, në cilësinë e denoncuesit. Bashkimi i kërkesave ankimore është bërë me vendim të KAS, në zbatim të nenit 65 shkronja “ç” të K.Pr.Administrative<sup>1</sup> meqenëse kërkesat ankimore bazohen në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore e për më tepër që janë ndaj të njëjtit vendim<sup>2</sup> të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pas vendimmarrjes për pranim për shqyrtim të të dy kërkesave ankimore në zbatim neneve 130 dhe 131 të K. Zgjedhor si dhe nenit 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, është zhvilluar seanca për shqyrtimin e të dy kërkesave ankimore.
3. E gjithë kjo procedurë administrative, në lidhje me themelin e saj, duke nisur që nga denoncimi, vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si dhe ky shqyrtim administrativ, bazohet në nenet 91 dhe 92 të K. Zgjedhor si dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
4. Në vendimin e saj shumica ka vlerësuar se edhe pse pranon “se deputeti Bujar Çela ka pozuar me banorë të pidentifikuar të Njësisë Administrative Hysgjokaj (sipas deklarimeve të veta dhe të denoncuesit), me certifikatat e lejeve të legalizimeve në duar, në mjediset e brendshme të banesave, në oborret ose në hyrjet e tyre. Rrethanat e rastit nuk provojnë shpërndarjen e certifikatave nga deputeti, por krijojnë bindjen, se ai ka marrë pjesë në proces. Nga ana tjetër, nuk rezulton e provuar që kryerja e veprimtarisë të jetë bërë në vende të hapura për publikun, në sheshe ose në njësitë e shërbimeve komunitare të zonës, apo që publiku të jetë ftuar në çfarëdo lloj forme për të marrë pjesë në veprimtari, apo media të ketë shoqëruar deputetin apo të ketë raportuar për ndonjërin nga këto veprimtari” arrin në përfundimin se nuk jemi në kushtet e një “veprimtarie publike” apo përdorimit të një ose më shumë “burimi” të organeve publike apo enteve publike në nivel qendror ose vendor. Në lidhje me “veprimtarinë publike” vetë K. Zgjedhor, në fjalinë e dytë të pikës 1 të nenit 92 të tij, parashikon se “Formojnë

<sup>1</sup> “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme: ... ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore”.

<sup>2</sup> Vendim nr. 7, datë 14.01.2021





veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”. Në lidhje me faktin nëse publikimet në llogaritë e deputetit në rrjetin social Facebook, konsiderohen apo jo veprimtari publike, shumica mban qëndrimin se “Postimi në llogarinë e deputetit në Facebook nuk e bën veprimtarinë publike. Postimi dhe veprimtaria janë dy ngjarje të dallueshme qartë nga njëra tjetra dhe të zhvendosura në kohë”. Për ne anëtarët e pakicës, ky është një qëndrim që bie ndesh me nenin 92 të K. Zgjedhor, pasi së pari përdorimi i rrjeteve sociale patjetër që ka në agjendë informimin e publikut rreth kësaj veprimtarie (shpërndarja e lejeve të legalizimeve) që është një nga kushtet e mjaftueshme për ta kualifikuar një veprimtari si publike, por së dyti bie ndesh dhe me interpretimin teleologjik (qëllimor) që i bëhet nenit 92 të K. Zgjedhor si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” në lidhje me vendosjen e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. **Për më tepër, në kushtet që “periudha katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve” me shumë mundësi do të vijojë të karakterizohet nga masat anti COVID-19, atëherë kjo e bën dhe më masive përdorimin e rrjeteve sociale, çka do të thotë se moskonsiderimi i përdorimit të tyre si “veprimtari publike”, do t’i shndërronte dispozitat e sipërcituara si të pazbatueshme dhe për rrjedhojë nuk do të arrihej synimi për garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.**

Në vijim të këtij interpretimi, ne anëtarët e pakicës jemi të mendimit se, ashtu sikundër ka konkluduar edhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në vendimin nr.7, datë 14.01.2021, objekt shqyrtimi nga KAS, deputeti Çela ka përdorur publikisht “burime” të organeve të administratës shtetërore në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, duke vepruar në fakt në shkelje të dispozitave ndaluese të Kodit Zgjedhor, por edhe të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Po ashtu, referuar paragrafit 2 të nenit 3 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të kësaj dispozite. Për këtë arsye, deputeti Çela nuk është konsideruar si subjekt i këtij procedimi administrativ nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Qëndrimi i mbajtur nga Komisioneri Shtetëror në këtë rast, konsiderohet nga ana jonë i drejtë dhe i argumentuar. Në këto kushte, në opinionin tonë ky duhet të ishte edhe argumenti me të cilin KAS duhet të kishte vendosur lënien pjesërisht në fuqi të vendimin nr. 7, datë 14.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur mospranimin e ankimit të subjektit politik LSI për pikën 1 të tij.

Në lidhje me veprimet/mosveprimet e z. Arben Qalliu, pavarësisht se *prima facie* dhe me interpretim literal ai (z. Arben Qalliu) nuk konsiderohet në kuptim të termit “burime” si burim njerëzor në zbatim të pikës 2 të nenit 91 të K. Zgjedhor për shkak se periudha e publikimit nuk është gjatë fushatës zgjedhore<sup>3</sup>,

<sup>3</sup> Sipas nenit 77 pika 1 të K. Zgjedhor “Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve”.



por në zbatim të nenit 92 të K. Zgjedhor dhe të pikës 2 të nenit 3<sup>4</sup> të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, **ai është një ndër subjektet që gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo formë, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.**

5. Në lidhje me këtë “kontribut” të z. Arben Qalliu, është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që me të drejtë, në vendimin nr. 7, datë 14.01.2021, ka arsyetuar se:

*“Lejet e legalizimit të shpërndara nga deputeti janë dokumente të prodhuara dhe në zotërimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnje, nën juridiksionin e së cilës është edhe njësi administrative Hysgjokaj.*

*Në parashikim të nenit 10, paragrafi 5, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, Drejtori i drejtorisë vendore është autoriteti që lëshon akte kadastrale për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial të drejtorisë dhe nxjerr aktet në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë”.*

*Në këtë rast, duke qenë se lëshimi i akteve kadastrale është në kompetencë të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Drejtorisë Vendore, përgjegjësia për shpërndarjen e këtij dokumentacioni në veprimtari publike në Njësinë Administrative Hysgjokaj, pjesë përbërëse e Bashkisë Lushnje, i ngarkohet Drejtorit të Drejtorisë Vendore A.SH.K Lushnjë, Z. Arben Qalliu, i cili me veprime apo mosveprime ka kontribuar në zhvillimin e këtij aktiviteti.*

*Z. Arben Qalliu me detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore ASHK Lushnjë ka nxjerrë me datë 09.12.2020, Urdhrin Nr. 3066 prot. për të shpërndarë në terren lejet e legalizimeve.*

...

*Në zbatim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, vendimi nr. 9/2020 i miratuar nga Komisioni Rregullator në KQZ, ka sanksionuar ndalimin e subjekteve të përcaktuara (neni 3, paragrafi 2 i vendimit 9/2020 të KQZ) që të drejtojnë të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo formë në veprimtari të ndaluara.*

*Z. Arben Qalliu nuk paraqiti asnjë provë për të dëshmuar se veprimtaria e tij si Drejtues i Drejtorisë vendore ASHK Lushnjë garanton respektimin e dispozitës ligjore të sipërcituar”.*

Më tej, në vendimin e sipërcituar të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, arsyetohet se:

*“Sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se veprimtaria e z. Qalliu duke lejuar dorëzimin e dokumenteve nga nëpunësit e tij në ambiente familjare, dhe jo në sportelet e dedikuara ose nëpërmjet postës sikundër përcaktohet në vendimin 954/2015, të Këshillit të Ministrave, është “diskrecion” në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Sipas nenit 3, paragrafi 3 të KPA “Diskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.*

<sup>4</sup> “Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administruar, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo formë, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.



Gjithashtu, Neni 11, Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parashikon se:  
“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) është i parashikuar me ligj;

b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;

c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe;

ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”.

Në kuptim të këtij parashikimi, z. Qalliu ka patur mundësinë të shfrytëzojë parashikimet e vendimit 954/2015, të Këshillit të Ministrave edhe të KPA për njoftimin dhe mënyrat e njoftimit në lidhje me dokumentacionin dhe respektimin e dispozitave të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, të cilat nuk i ka shfrytëzuar, por nën një diskrecion jo të ligjshëm ka lejuar dorëzimin e dokumenteve për të cilat vetë ai është përgjegjës jo në përputhje me ligjin.”

6. **Për ne anëtarët e pakicës, është e mjaftueshme që z. Arben Qalliu për shkak të funksionit që ka, të konsiderohet në kushtet e shkeljes së neneve 91 dhe 92 të K.Zgjedhor për shkak të mosrespektimit të nenit 3 pika 1.3 shkronja “a” dhe pika 2 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, për vetë faktin se me veprime (duke autorizuar specialistë të institucionit që ai drejton) dhe mosveprime (duke mos dorëzuar lejet e legalizimit në sportel ose nëpërmjet postës), ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Është pikërisht autorizimi që K. Zgjedhor i jep Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të përcaktuar ndër të tjera edhe rastet që mund të formojnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, me të cilin ky i fundit ka sanksionuar se kontributi në çfarëdolloj forme në veprimtari publike të ndaluara konsiderohet si në shkelje të K. Zgjedhor. Për këtë arsye, është e panevojshme që në publikimet në rrjetin social Facebook të jenë pjesë e tyre z. Arben Qalliu apo specialistë në varësi të tij. **Kontributi i z. Arben Qalliu në këtë rast është krejtësisht evident sepse ka të bëjë me shpërndarjen e lejeve të legalizimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që rregullon shpërndarjen e tyre.****

7. Për sa më sipër, ne anëtarët e pakicës, jemi të mendimit që kërkesa ankimore e z. Arben Qalliu duhej rrëzuar si e pambështetur në ligj dhe në prova.

8. Në lidhje me ankimin e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, ai duhej pranuar pjesërisht për pjesën e kualifikimit të kundërvajtjes administrative të kryer nga z. Arben Qalliu. Në vendimin nr. 7, datë 14.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në lidhje me kualifikimin e kundërvajtjes administrative të z. Arben Qalliu, ai ka arritur në përfundimin se:

“... veprimet e z. Arben Qalliu ka shkelur nenin 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë dhe të Vendimin Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të nxjerrë në zbatim të tij.

Neni 10 i vendimit 9/2020 përcakton se “Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë,

sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.” Për sa më sipër z. Arben Qalliu nuk është subjekt i kësaj dispozite”.

Ky arsyetim nuk qëndron si në raport me nenin 10 të vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por po ashtu edhe me nenin 171 të K. Zgjedhor.

9. Më konkretisht, duke qenë se kemi të bëjmë me një kundërvajtje administrative, do i referohemi si fillim ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i cili në nenin 6 të tij parashikon se:

“Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen:

a) me ligj;

b) me akte të këshillit bashkiak apo të këshillit të komunës, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta”.

Në rastin objekt shqyrtimi administrativ, jemi në kushtet e një kundërvajtjeje administrative që parashikohet në ligj, më konkretisht në nenin 171 pika 1 të K. Zgjedhor. Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në zbatim të autorizimit që i ka dhënë ligji (K. Zgjedhor) në zbatim të neneve 20 pika 1 shkronja “c”<sup>5</sup>, 91 pika 5 dhe 92 pika 7 të tij, ka miratuar vendimin nr. 9/2020 dhe pasi ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme përdorimin/shpërdorimin e burimeve publike dhe rastet që mund të formojnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, në nenin 10 pika 1 të këtij vendimi, pa cënuar nenin 6 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, ka sanksionuar se “Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, **pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar**”. Debati që shtrohet në interpretimin e kësaj dispozite ka të bëjë atë se çfarë kuptojmë me “**ndalim të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**”. A duhet kuptuar vetëm rasti i një veprimtarie të raportuar në zbatim të pikës 4 të nenit 4 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe më tej të “**Ndaluara nga KQZ-ja**” në zbatim të pikës 1 të nenit 9 të po këtij vendimi apo duhen kuptuar dhe ato raste kur veprimtaria konsiderohet e ndaluar *apriori* si ai i pikës 1.3 të nenit 3 të po të njëjtit vendim që parashikon se ““*veprimtari të ndaluara*”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: a) shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve”. Për ne anëtarët e pakicës, me “**ndalim të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**”, kuptohen si rastet që ky ndalim është bërë nëpërmjet akteve administrative individuale të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (pas raportimit të një veprimtarie), por po ashtu edhe rastet kur ky ndalim është sanksionuar nëpërmjet një akti administrativ me karakter të përgjithshëm për të cilin ndalimi është sanksionuar me vendim të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve siç është ai i pikës 1.3 të nenit 3 të vendimit të sipërcituar. Pikërisht ky është edhe qëllimi i Komisionit Rregullator që në nenin 10 të vendimit nr. 9/2020 të tij ka përdorur termin “**pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**”. Nëse qëllimi do ishte për të sanksionuar me këtë dënim administrativ vetëm ato veprimtari publike të cilat janë raportuar dhe

<sup>5</sup> “Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për: ... c) rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, **kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e KQZ-së për zbatimin e ndalimit**”

janë ndaluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, atëherë do të përdorej termi “pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve”.

10. Po ashtu është e rëndësishme të interpretohet edhe vetë neni 171 pika 1 e K. Zgjedhor që parashikon se “*Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë*”. Në këtë rast është e rëndësishme ti japim përgjigje pyetjes nëse do të konsiderohet z. Arben Qalliu si person i ngarkuar me detyra sipas K. Zgjedhor. **Meqenëse vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka dalë në zbatim të autorizimit që K. Zgjedhor ka përcaktuar në nenet 20 pika 1 shkronja “c”, 91 pika 5 dhe 92 pika 7 të tij dhe është pikërisht ky vendim që në pikën 2 të nenit 3 të tij e ngarkon me detyrën për të mos drejtuar, marrë pjesë apo kontribuojë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi, atëherë jemi në kushtet që z. Arben Qalliu ka shkelur dispozita të Kodit Zgjedhor që e ngarkojnë me detyra.** Këtu duhet të mbajmë parasysh edhe faktin që neni 171 i K. Zgjedhor është një dispozitë e pandryshuar e K. Zgjedhor që nga miratimi i tij fillestar në vitin 2008, ndërkohe që me katër ndryshimet e mëtejshme<sup>6</sup> është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme spektri i personave të ngarkuar me detyra nga ky kod, pavarësisht nëse detyrimet karakterizohen nga veprime apo mosveprime si në rastin e z. Arben Qalliu. Për këtë arsye, për të kuptuar *ratio legis* të kësaj dispozite duhet që doemos të bëjmë një interpretim historik të saj që nga miratimi i K. Zgjedhor në vitin 2008 e duke përfshirë edhe të gjithë ndryshimet e mëtejshme.

11. Ka një element që duhet shtruar për diskutim në rikualifikimin e kundërvajtjes administrative të z. Arben Qalliu duke ndryshuar vendimin nr. 7, datë 14.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe dënimin me gjobë të z. Arben Qalliu në zbatim të nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor çka do ta rëndonte pozitën e ankimesit Arben Qalliu përderisa marzhi i dënimit administrativ me gjobë tashmë do të variojë nga 3,000 lekë në 90,000 lekë. Në kushtet kur KAS me unanimitet pranoi për shqyrtim të dy kërkesat ankimore, si atë të z. Arben Qalliu, por po ashtu edhe atë të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, duke e legjitimuar këtë të fundit si palë, atëherë jemi në kushtet që janë dy palë ankimese për vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve objekt i këtij shqyrtimi administrativ. Në këto kushte nuk është i zbatueshëm parimi i *reformatio in peius* (parimi i mosrëndimit të pozitës së ankimesit) për z. Arben Qalliu, i sanksionuar në nenin 137 pika 5 të K.Pr.Administrative, pasi së pari në këtë shqyrtim administrativ po shqyrtohen dy kërkesa ankimore nga dy palë të ndryshme që tërheqin interesa të kundërta me njëra tjetrën dhe së dyti Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve nuk konsiderohet si organ publik epror i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në zbatim të nenit 134 shkronja “b” të K.Pr.Administrative, por si një organ tjetër publik i përcaktuar shprehimisht me ligj në zbatim të nenit 134 shkronja “c” të K.Pr.Administrative, pasi neni 137 i këtij kodi i referohet specifikisht “*procedurës së shqyrtimit të ankimit nga organi epror*”. **Si përfundim, kualifikimi i kundërvajtjes administrative sipas nenit 171 pika 1 e K. Zgjedhor dhe jo sipas pikës 2 të këtij neni, çka do të sillte si pasojë një dënim administrativ me gjobë më të lartë për z. Arben Qalliu, përveçse është konform vetë K. Zgjedhor sa i përket veprimtarisë së tij, por është edhe në përputhje me K.Pr.Administrative.** Në këtë mënyrë do të përmbushej dhe qëllimi i ligjvënësit për dënim administrativ proporcional dhe do kishte efekt parandalues për arritjen e synimit për garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve

<sup>6</sup> Me ligjet nr. 74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe nr. 118/2020, datë 5.10.2020



**të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.**

12. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimuesi Arben Qalliu është e pabazuar dhe ajo duhej të ishte rrëzuar nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që kërkesa ankimore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim ishte pjesërisht e bazuar dhe duhej pranuar po pjesërisht sa i përket kualifikimit të kundërvajtjes administrative të z. Arben Qalliu në zbatim të nenit 171 pika 1 të K. Zgjedhor dhe ta dënonte atë me një dënim administrativ me gjobë që t'i përgjigjej rëndësisë së kundërvajtjes dhe pasojave që kanë ardhur nga veprimi i kundërvajtësit.

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**